



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.202__

V E N D I M

Nr. 409, Datë 29.09.2021

PËR

KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...}
PËR NË FORMIMIN FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS,
PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQATAR, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 29.09.2021, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatorja znj. Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatës znj. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2020-2021,

V Ë R E N:

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Znj. {...} është candidate për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar, në kushtet kur:

a) është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, në bazë të Raportit të Vlerësimit Përfundimtar të datës 19.06.2020, se plotëson kriteret e pranimit në formimin fillestar për magistrat sipas nenit 28 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin);

b) ka marrë pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës sipas nenit 31 të Ligjit të Statusit, u përfshi në listën e renditjes së kandidatëve fitues në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, të miratuar me Vendimin nr. 22, datë 16.07.2020, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkresën nr. 492 prot., datë 17.07.2020 (protokolluar në Këshill me aktin nr. 3383 prot., datë 17.07.2020).

2. Me Vendimin nr. 257, datë 20.07.2020, mbështetur në nenin 32 të Ligjit për Statusin, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar për magjistratë, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...} si relatore u caktua znj. Marçela Shehu.

3. Më datë 20.07.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatja, znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatores së kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatores së caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditör, kandidatja, znj. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidatja nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatoren e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Po më datë 20.07.2020, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidates, znj. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidatja, znj. {...}, depozitoi formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit të përcaktuar në Vendimin nr. 257, datë 20.07.2020 për dorëzimin e një prej formularëve, që ishte data 04.08.2020, ajo dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datën 28.07.2020, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar

në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për znj. {...}.

8. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Gjatë procedurës së verifikimit, mbështetur në të dhënat e deklaruara nga vetë kandidatja në jetëshkrimin e depozituar në rastin e aplikimit pranë Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me eksperiencën e saj në punë (punësimin), bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion nga subjektet që kanë mbikqyrur disiplinën në punë të kandidatës znj. {...}, të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KRITERET E PRANIMIT NË FORMIMIN FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

A. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat

10. Sa i përket kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përfshirë edhe për kandidaten {...}, si dhe më lart u parashtrua, vlerësimi për plotësimin e tyre është bërë, në momentin e kandidimit, nga ana e Shkollës së Magjistraturës, bazuar kjo në nenin 30¹ (“Kandidimi dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve”) të Ligjit të Statusit. Në përfundim të vlerësimit, Shkolla ka përgatitur dhe i ka paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat, ku pas komenteve të Këshillit, më datë 19.06.2020, Shkolla ka miratuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare Raportin e Vlerësimit Përfundimtar, përfshirë dhe listën e kandidatëve, të cilët plotësonin kriteret e

¹“1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit shkurt të çdo viti. 2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit. 3. Deri në datën 15 mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse kandidati përmbush kriteret e kandidimit, të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. 4. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit mars të çdo viti. Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar, duke marrë në konsideratë komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij. 5. Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe aktet nënligjore përkatëse”.

parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidatja {...}.

11. Gjithsesi, për kandidaten {...}, u konsiderua verifikimi sërish i disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përcaktuar në nenin 28 të Ligjit të Statusit.

11.1 Për këtë u mbajt në konsideratë diferenca kohore mes momentit të aplikimit të kandidatëve (Shkurt 2020), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kriterëve nga ana e tyre (19 Qershor 2020), si dhe momentit aktual, kur Këshilli duhet të shprehet për kualifikimin ose jo të kandidatëve për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, të cilët kanë rezultuar fitues në provimin e pranimit (Shtator 2020). Dhe po ashtu, nga ana tjetër, u mbajt në konsideratë dhe fakti se shumica e kriterëve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990).

11.2 Gjithashtu, për këtë u mbajt në konsideratë se një verifikim i tillë është detyrim ligjor për Këshillin e Lartë Gjyqësor që buron nga neni 32 (“Verifikimi i pasurisë dhe figurës”)², pika 4, shkronja “c”, të Ligjit të Statusit, sipas të cilit Këshilli ka detyrimin të verifikojë

² 1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë dhe figurës. 2. Brenda një jave nga publikimi i listës përfundimtare, sipas nenit 31, të këtij ligji, për secilin kandidat të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. 3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre. 4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet në Shkollën e Magjistraturës kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit. 5. Deri në datën 5 shtator të çdo viti, Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. 6. Kandidatët kanë të drejtë të njihen me dosjen dhe të ankohen në gjykatën kompetente ndaj vendimit të Këshillave, brenda 5 ditëve. Gjykata kompetente vendos për ankimin, brenda dy javëve nga paraqitja e tij. 7. Pas përfundimit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, Këshillat miratojnë dhe publikojnë në fund të muajit shtator të çdo viti, listën përfundimtare të kandidatëve magjistratë, që pranohen në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar trevjeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar sipas nenit 29 dhe duke respektuar me përpikëri renditjen e kandidatëve në listën e parashikuar në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji.

ekzistencën e çdo shkakut përjashtues (të parashikuar nga ligji) nga kandidimi për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Përveç kësaj, u mbajt në konsideratë detyrimi i Këshillit për verifikimin e kriterëve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra ato sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, është një detyrim konstant i Këshillit qoftë në momentin e emërimit të të diplomuarve për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës, ashtu edhe gjatë karrierës së tyre si magjistrat (gjyqtar), referuar për këtë në nenet 35, 64 dhe 66 të Ligjit të Statusit.

12. Konkretisht, për kandidaten u verifikua:

a) *pasja nga ajo e zotësisë së plotë për të vepruar*, ku për këtë nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) *pasja e shtetësisë shqiptare*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, është depozituar dokumenti Kartë identiteti, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 22.05.2009, ku pasqyrohet përberësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast pasqyrohet “shqiptare”, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidatë. Gjithashtu, nga verifikimi i bërë, më datë 04.09.2020, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas certifikatës personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidatja vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

c) *gjendja gjyqësore*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kjo e fundit ka kryer verifikim në regjistrin elektronik gjyqësor të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) duke printuar në letër Certifikatë Elektronike datë 24.02.2020, ndërkohë që gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidatës, u administruan Shkresa nr. 7733/1 prot., datë 30.07.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidatja nuk ka shënime në sistem;

ç) *disiplina në punë*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës ka depozituar Librezë pune, ndërkohë që gjatë verifikimit u administrua Shkresa nr. 611/1 prot. datë 05.08.2020, e Fakultetit të Drejtësisë Tiranë dhe shkresa e datës 03.08.2020 e Shoqërisë SARA-El sh.p.k. Sipas këtyre dokumenteve kandidatja nuk është e larguar nga puna për shkaqe disiplinore apo ai nuk ka masë disiplinore në fuqi;

d) *qenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë datë 27.02.2020 në të cilën deklaron se nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i

shërbimeve sekrete, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidates bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

13. Për kriteret e tjera të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës u konsiderua vlerësimi i bërë nga kjo e fundit dhe konkretisht për:

a) *pasjen e kriterit arsimor*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, janë depozituar dokumentet :

- “Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë në Drejtësi” me nr. 003024, datë 20.07.2010, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë shoqëruar me çertifikatë notash datë 20.07.2010;

- “Diplomë Doktorate” me nr. 1461 datë 08.02.2017 lëshuar nga Universiteti i Tiranës;

b) *pasjen e përvojës profesionale*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës është depozituar dokumenti “Librezë Punë”, sipas të cilit kandidatja ka përvojë profesionale aktive me kohë të plotë në pozicionet juriste pranë Shoqërisë SARA-El sh.p.k dhe pedagog/lektor pranë Fakultetit të Drejtësisë Tiranë.

c) *mos anëtarësinë në parti politike në kohën e kandidimit*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë datë 27.02.2020 në të cilën deklaron se nuk është anëtar i ndonjë partie politike;

ç) *mosqenien anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë datë 27.02.2020 në të cilën deklaron se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, përveç se referuar moshës së saj (e datëlindjes 21.02.1987), ajo nuk mund të ketë qenë e tillë.

B. Për kriterin e pasurisë

14. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

15. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 259/25 prot., datë 25.09.2020.

15.1 Sipas këtij Raporti ILDKPKI-së, kandidatja {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

15.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit është kryer kontrolli i plotë për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidatja {...}, duke konkluduar se për kandidaten:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

15.3 Këshilli, bazuar në konstatimet e cituara në raportin e mësipërm, ka vlerësuar të nevojshme t'i kërkojë ILDKPKI-së hartimin e një raporti shtesë në lidhje me vërtetësinë, saktësinë dhe përputhueshmërinë e të dhënave të deklaratës së pasurisë dhe interesave private të subjektit/të kandidates znj. {...}, dorëzuar pranë tyre, me datë 29.07.2019, me deklarinimet periodike vjetore të subjektit, pra kandidates znj. {...} si person i lidhur me z. Gramoz {...}.

15.3.1 Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, ILDKPKI-ja ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin shtesë nr. 2520/24 datë 18.11.2020 duke konkluduar se :

“Në përmbledhje sa më sipër, rezulton se përputhet deklarimi i bërë nga kandidatja {...} në deklaratën e kandidates, dorëzuar më datë 03.08.2020, me deklarinimet e bëra prej saj, si person i lidhur me subjektin Gramoz {...}, në deklaratat e interesave private Periodike Vjetore dhe Deklaratën e Pasurisë Vetting. Si burime financiare për krijimin e asetëve të deklaruara, rezulton se janë përdorur të ardhurat e kandidates dhe bashkëshortit të saj, si dhe kredia bankare në Union Bank. Në asnjë nga deklaratat e interesave private ndër vite dhe atë vetting, nuk rezulton që kandidatja {...} të ketë përdorur burime financiare të prindërve të saj apo personave të tjerë.”

15.4 Në vijim të procedurës së verifikimit, pas kërkesës së paraqitur nga Këshilli, kandidatja ka dhënë sqarime shtesë lidhur me konstatimet përkatëse referuar burimit të krijimit të pasurisë apartament banimi.

15.5 Në vijim, Këshilli ka vendosur t'i komunikojë kandidates gjetje në procedurën e verifikimit, lidhur me të provuarit e burimit të krijimit të pasurisë apartament banimi, regjistruar në emër të saj dhe të ish bashkëshortit të saj.

16. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...} u kërkua informacion Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

16.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 15042/9 prot., datë 07.08.2020, ku për kandidaten {...} nuk jepen të dhëna për aktivitete tregtare.

16.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 14353/1 prot., datë 10.08.2020, ku për kandidaten {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

17. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

18. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj.

19. Lidhur me gjetjet e konstatuara, që lidhen me të provuarit e burimit të ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në emër të saj dhe të ish bashkëshortit, Këshilli vlerësoi dhe analizoi përmbajtjen dhe analizën ligjore dhe ekonomike të Aktit të Përfundimit të Kontrollit të Plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Private të Kandidatit për Institucionet e Sistemit të Drejtësisë, e kandidates {...}, hartuar nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si organi kompetent ligjor për kontrollin e deklarimit dhe legjitimitetit të burimeve njerëzore të pasurive të deklaruara dhe konfliktit të interesave nga subjektet që përcakton Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”* i ndryshuar, sipas të cilit rezultojnë se deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë; kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave. Nga verifikimi i kryer nga ky institucion, në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësisë të tij funksionale, në respektim të kërkesave që përcakton ligji në fuqi për realizimin e këtij verifikimi, nga të dhënat dhe dokumentacioni i mbledhur nga ky institucion, ka rezultuar se deklarimi i kandidates është i saktë dhe se provohet burimi i ligjshëm të pasurive të deklaruara prej saj.

20. Po në analizë të këtij Akti Kontrolli, Këshilli vlerëson se për sa kohë, të ardhurat për blerjen e apartamentit, në pjesën më të madhe të tyre, përveç pjesës së financimit me anë të kredisë bankare, lidhen me *kohën e përpara lidhjes së martesës* së kandidates me ish bashkëshortin, pra përpara kohës së ekzistencës së bashkësisë ligjore, *kandidatja nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të provuar* burimin e krijimit të këtyre të ardhurave. Këshilli vlerëson se kandidatja *nuk mund të mbartet me detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të çdo të ardhure të krijuar dhe të deklaruar nga ish bashkëshorti, para lidhjes së martesës*, ku përfshihen edhe pjesa më e madhe e të ardhurave nga emigracioni 20 vjeçar i ish bashkëshortit, deklaruar si një prej burimeve të blerjes së apartamentit në vitin 2014. Theksojmë se si një nga burimet për blerjen e apartamentit, janë deklaruar në Deklaratën e

dorëzuar në ILDKPKI, të ardhurat nga emigracioni 20 vjeçar i ish bashkëshortit, që në pjesën më të madhe të krijimit të këtyre lidhen me kohën para martesë.

21. Gjatë procedurës së verifikimit, ka rezultuar gjithashtu se kandidatja nuk është aktualisht bashkëpronare në pasurinë apartament banimi e në këto kushte Këshilli vlerëson se ky fakt, kjo situatë e re ligjore si dhe në tërësi *ndryshimi i të dhënave* që lidhen me verifikimin e disa prej kritereve ligjore, gjatë procedurës së verifikimit, për sa kohë ky verifikim nuk ka përfunduar dhe nuk është përmbysur me një vendim final të Këshillit, mund të afektojë vendimmarrjen e Këshillit. Kështu humbja e shtetësisë shqiptare apo e zotësisë për të vepruar gjatë procedurës së verifikimit, dënimi me një vendim penal të formës së prerë, konstatimi i një sjellje të papërshtatshme etike dhe morale, e identifikuar si e tillë gjatë procedurës së verifikimit, janë situata të tilla, të cilat nuk mund të mos vlerësohen dhe konsiderohen nga Këshilli, për sa kohë ato ndikojnë vendimmarrjen eventuale të Këshillit e për sa kohë procedura e verifikimit nuk ka përfunduar me një vendim përfundimtar të Këshillit.

22. Në rastin konkret, Këshilli nuk mund të mos vlerësojë faktin që tashmë kandidatja nuk është bashkëpronare në pasurinë apartament të deklaruar prej saj, as përdoruese e saj, situatë e cila, nëse në një rast tjetër, do të kishte ndodhur përpara momentit të kandidimit, nuk do të kishte qenë pjesë e diskutimit në vendimmarrjen e Këshillit.

23. Këshilli, në vlerësimin e tij tërësor rreth situatës faktike dhe ligjore që lidhet me verifikimin e kushteve dhe kritereve të kandidatës {...}, duke konsideruar faktin që analiza ligjore dhe ekonomike e kryer nga ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar probleme lidhur me verifikimin e pasurisë së kandidatës; duke konsideruar faktin që përveç shumës së kredisë, pjesa më e madhe e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit, rezultojnë të ardhura të krijuara nga personi i lidhur, ish bashkëshorti, para lidhjes së martesës, pra para datës 25.11.2011, periudhë për të cilën ish bashkëshorti nuk ka pasur detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre; duke konsideruar faktin që gjatë verifikimit nuk janë evidentuar të dhëna apo indicie për përfshirje të kandidatës në ndonjë veprimtari apo aktivitet të paligjshëm që eventualisht mund të ndikonte në verifikimin e kriterit të pasurisë; duke konsideruar gjithashtu që gjatë verifikimit u evidentuan rrethana që afektojnë analizën e një prej kritereve ligjore që vlerësohen nga Këshilli; bazuar në çmuarjen e tij dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ, konkludon se kandidatja kalon testin e verifikimit të pasurisë.

C. Për kriterin e figurës

24. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

25. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

26. Nga informacioni i ardhur nga Byroja Kombëtare e Hetimit me shkresën nr. 396/1 prot. datë 28.09.2021, ka rezultuar se për kandidaten {...} nuk ka informacion.

27. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidates {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që çenojnë sigurinë kombëtare apo aktivite të kundërligjshme.

28. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, asaj iu kërkua dhe plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 22.07.2020, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të saj në lidhje me figurën dhe integritetin.

29. Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës në të gjitha prokuroritë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, duke përcjellë në Këshill, me Shkresën nr. 1166/36 prot., datë 28.09.2020, protokolluar me aktin nr. 3647/39, datë 29.09.2020, përgjigjet zyrtare të 29 (njëzetënëntë) prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, apelit si dhe përgjigjen e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Referuar përmbajtjes së këtyre përgjigjeve rezulton se për kandidaten {...}, nuk është regjistruar kallzim/referim/procedim penal, nuk ka qenë ose është në hetim, nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi, nuk është dënuar me vendim jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale.

30. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 5543/1 prot., datë 01.10.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3631/2 datë 09.10.2020, ka dërguar të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidaten {...}, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

31. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidatja {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të

personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, duke konkluduar se kandidatja : “- ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 22.7.2020; - formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të web; - në formularin e vetëdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nuk ka rezultuar ndryshime të të dhënave të gjendjes civile apo gjendjes gjyqësore, nga ato të deklaruara; - deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme”. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

32. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj. Konkretisht, të dhëna në lidhje me:

- a) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;
- b) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të nënshkruara, të autorizimit për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;
- c) ekzistencën ose jo të lidhjeve ose kontakte të papërshtatshme të kandidates me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) qenien ose jo të kandidates, anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- d) qenien ose jo të kandidates, bashkëpunëtore, informatore ose agjente e shërbimeve të inteligjencës.
- dh) ekzistencën ose jo të ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e saj mbi të cilën të ngrihen dyshime për pranueshmërinë e saj për në formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës.

III. KONKLUZIONE

33. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

34. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja përmbush këto kriterë, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj. Nisur nga

kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidates për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, në nenin 86, shkronja “ë” dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...}, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2020-2021.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR